



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **INTERVISTA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË, AMBASADORIT GUIDO DE SANCTIS, PËR EMISIONIN “PA CENSURË” NË RTSH**

*Transmetuar më 27 shkurt 2023*

*Intervistoi: Elona Meço*

### **Mirëmbërëma!**

**Emisioni “Pa censurë” ka sot në fokus zgjedhjet dhe nivelin e demokracisë në Shqipëri, por jo nga këndvështrimi i partive politike shqiptare. Sot me mua është ambasadori i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Guido De Sanctis. Faleminderit, z. Ambasador, që jeni me mua sonte dhe shpresoj të jeni sa më pak diplomat në përgjigjet tuaja.**

**Ju jeni emëruar para pak muajsh si kreu i misionit këtu në Shqipëri. Çfarë synoni të arrini gjatë këtij mandati?**

Faleminderit! Prezenca e OSBE-së ka një histori të gjatë në Shqipëri dhe prandaj kjo është një detyrë shumë delikate për mua. Objektivi im është të konsolidoj dhe të përmirësoj aftësinë e Prezencës së OSBE-së për të përmbushur mandatin e saj. Thënë konkretisht, përmbushja e mandatit tonë do të thotë të dëgjojmë nevojat e institucioneve dhe të shoqërisë civile shqiptare, në mënyrë që të mund të ndihmojmë Shqipërinë në fushat e veprimtarisë sonë. E kam fjalën këtu për demokratizimin, shtetin e së drejtës, qeverisjen e mirë dhe gjithçka që ka të bëjë me jetën politike të vendit. Ne jemi këtu për të dëgjuar nevojat tuaja dhe për t’u përgjigjur, shpresoj, gjithnjë e më mirë, gjatë mandatit tim.

**Nga këndvështrimi juaj, ambasador, cilat janë problemet kryesore të cilësisë së demokracisë në Shqipëri?**

Le ta nisim nga diçka për të cilën të gjithë biem dakord. Burimet më të mira të çdo vendi janë njerëzit e tij. Dhe karburanti më i mirë për jetesën qytetare është besimi i ndërsjellë. Ka momente në historinë e çdo vendi ku besimi i ndërsjellë mund të luhetet: mund të jetë i lartë, mund të jetë më i ulët. Mendoj se Shqipëria është një nga ato raste ku i duhet dhënë më shumë vëmendje ushqimit të besimit të ndërsjellë. Besimi i ndërsjellë mbështetet te dialogu. Do të doja t’ju kujtoja se dialogu është ndër parimet mbi të cilat u themelua OSBE-ja. Kur lindi si KSBE më 1975, ideja e themeluesve të saj ishte të përdorej dialogu sa herë të kishte një problem për të zgjidhur.

**Në fakt, vitin e shkuar Shqipëria e kryesoi OSBE-në në nivelin më të lartë të saj, por, në fakt, në Shqipëri nuk pati asnjë dialog mes partive politike. Është problem ky?**

Veprimtaria jonë këtu me bashkëbisedues të ndryshëm... ne flasim me të gjithë dhe u japim të gjithëve të njëjtin mesazh. Mesazhi është se mund të ndodhë në një demokraci që të lëshohen fjalë të rënda. Kjo është normale. Ajo që nuk është normale është përdorimi i kërcënimeve, përfytyrimi i skenarëve krizash. Nuk është kjo demokracia. Dua t’ju kujtoj që në ende mbajmë një stil tipik të OSBE-së, të cilin mund ta përkufizoj si stil të heshtur. Bashkëbiseduesit tanë i marrin shumë qartë mesazhet tona për dialog, por nuk është në interesin tonë që çdo gjë që bëjmë të bëhet publike apo të thuhet në media, pasi mendojmë se këto mesazhe duhen shtjelluar nga ne dhe nga bashkëbiseduesit. Por ju siguroj se ne i japim shumë qartë këto mesazhe.

**Z. Ambasador, ka një perceptim sikur roli i OSBE-së nuk është më aq i rëndësishëm sa ç'ka qenë vite më parë këtu në Shqipëri. Kjo vjen për shkak se ju jeni tërhequr si ndërmjetës; këtu në Shqipëri nuk ka më kriza siç ka pasur më përpara, kriza politike e kam fjalën; apo ka rënë besimi tek OSBE-ja?**

Situata ndryshon. Shqipëria është një vend i vjetër me histori komplekse dhe me traditë shumë të gjatë, por ka edhe një Shqipëri të re, që rilindi nga një periudhë e tmerrshme, 30 vjet më parë. Gjatë këtyre 30 viteve, shumë gjëra kanë ndryshuar, pasi Shqipëria po ecën me bindje në rrugën e demokratizimit dhe të integritit në strukturat ndërkombëtare. Dhe po bën një punë shumë të mirë, meqë ra fjala. Ju përmendët Kryesinë e OSBE-së, në vitin 2020 dhe Shqipëria mori lëvdata për punën që bëri në një vit të vështirë si 2020-a, e kam fjalën këtu për kovidin. Me ndryshimin e situatës, ndryshon edhe përgjigjja ndaj situatës. Nëse përdorim një paradoks, OSBE-ja e ka bërë punën e saj atëherë kur mund të thuhet se OSBE-ja nuk nevojitet më në një vend. Ne nuk jemi të paduruar për të ikur nga vendi, natyrisht, unë vetë bëj një jetë shumë aktive këtu, por, objektivisht, ne punojmë për t'u bërë sa më pak të nevojshëm. Ende punojmë në stilin e heshtur që përmenda dhe nga bashkëbiseduesit e mi – nga institucionet dhe shoqëria civile – kam dëgjuar vetëm vlerësime. Kjo më jep bindjen se puna jonë këtu është ende e vlerësuar dhe ende e nevojshme. Pra, nuk do të thosha që jemi më pak të rëndësishëm. Jo, nuk jam dakord me këtë.

**Z. Ambasador, në fakt, kur flitet për OSBE-në, gjithmonë na vijnë në mend zgjedhjet. Çfarë mendoni për përgatitjen e zgjedhjeve të 14 majit në Shqipëri?**

Ky është një moment i rëndësishëm për jetën demokratike të Shqipërisë. Fatmirësisht, kemi punuar shumë mirë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, unë jam takuar me Komisionerin, dhe mendoj që përgatitjet janë në kohë dhe ata po e përgatisin terrenin në mënyrë shumë efektive. Prandaj nuk jam i shqetësuar në këtë drejtim.

**Ndërkohë, raporti i ODIHR-it ka ngritur si shqetësim kryesor se partia në pushtet po ndërhyjnë në çështjet e administratës, për zgjedhjet, duke përdorur burimet shtetërore dhe blerjen e votës. A ndani ju të njëjtin shqetësim me ODIHR-in?**

Ju po i referoheni dokumentit më të fundit të ODIHR-it, që quhet “Raporti i vlerësimit të nevojave”. Ky raport u botua, nëse nuk gaboj, më 15 shkurt, pra vetëm disa ditë më parë. Di që publiku dhe institucionet shqiptare e kanë pritur me padurim të lexojnë ç' thuhet në të. Nëse e lexoni me kujdes, do të vini re se OSBE/ODIHR-i i fillon të gjitha pikat me të njëjtat fjalë: “Bashkëbiseduesit na thanë se...” dhe vijohet me pretendimet, si ato që përmendët ju ose të tjera gjëra. Pra, tani për tani, kjo është çka ODIHR-i, me punën e tij të duruar, ka mbledhur nga bashkëbiseduesit në Shqipëri. Nuk është ajo që thotë vetë ODIHR-i. Është ajo që bashkëbiseduesit vendas i kanë thënë ODIHR-it. Ata thjesht e ka vendosur në këtë dokument, i cili përbën kornizën e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të majit.

**Deri tani nuk është verifikuar një gjë e tillë, nëse ekzistojnë realisht këto shqetësime?**

Verifikimi do të bëhet kur ODIHR-i të dërgojë vëzhguesit afatshkurtër dhe afatgjatë, që pritet të mbërrijnë. Jam i sigurt që ju e njihni këtë mekanizëm. Ata do të përpiqen të kuptojnë më mirë se ku mbështeten këto pretendime. Le të mos harrojmë se këto episode nuk janë në kompetencën e drejtpërdrejtë të OSBE-së apo të ODIHR-it për t'u zgjidhur. Po flasim për gjëra që mund të ndodhin në territorin dhe në juridiksionin e Shqipërisë. Jam i sigurt se pak kohë pas

zgjedhjeve të 14 majit do të ketë një raport të detajuar të ODIHR-it mbi gjetjet e tyre dhe rekomandime të tjera, për të cilat do të punojmë duke pasur parasysh zgjedhjet parlamentare të 2025-s.

**Ndërkohë, për herë të parë pas 30 vjetësh, ndërhyrjet e fundit që iu bënë Kodit Zgjedhor në Shqipëri, në vitin 2021, u bënë pa një kompromis mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. A duhet të ndryshojë ky Kod Zgjedhor që është aktualisht, i bërë pa konsensus, dhe a duhet që palët të ulen për ta ndryshuar këtë? Ai dialogu që përmendët pak më parë.**

Ju po i referoheni mënyrës se si funksionon një demokraci. Një demokraci funksionon në shumë mënyra. Një mënyrë është që njëra palë merr shumicën për një periudhë të caktuar dhe kush ka shumicën ka edhe mundësinë të shkojë në parlament e të ndryshojë ligjet me shumicën e vet. Ky është një nga parimet e demokracisë. Nuk funksionon vetëm kështu. Kjo nuk është e mjaftueshme. Parimi tjetër është që, nga ana tjetër, pra pala që mori pakicën, të cilën e quajmë opozitë, cilado parti qoftë ajo, duhet të jetë e fortë dhe të jetë në gjendje të dialogojë me shumicën, në mënyrë që të gjenden zgjidhje më të mira. Por nuk përbën problem në vetvete fakti që shumica merr vendime për çështje të caktuara. Thënë kjo, zbatimi i ligjeve që miratohen nga shumica duhet të bëhet në mënyrën e duhur. Puna jonë e përditshme është të punojmë së bashku me institucionet shqiptare dhe t'i ndihmojmë ato të gjejnë zgjidhjet më të mira për legjislacionin dhe zbatimin e ligjit.

**Pra, sipas jush nuk përbën problem që Shqipëria ka një ligj zgjedhor jokonsensual, siç e ka pasur gjithmonë këto 30 vitet e fundit?**

Nuk po i referohem Kodit Zgjedhor. Kur flas për parimin e demokracisë dua të vë në dukje se demokracia është edhe sundimi i shumicës. Kodi Zgjedhor është një dokument i rëndësishëm. Ai duhet përmirësuar. Ndoshta puna me zgjedhjet dhe me legjislacionin e zgjedhjeve është ajo me të cilën merremi më shumë. Ne bëjmë shumë gjëra, siç jua thashë, mandati ynë është shumë i gjerë, por zgjedhjet janë përparësia kryesore. Objektivi ynë është të përmbushen rekomandimet e ODIHR-it dhe të dëgjojmë cilat janë interesat e institucioneve shqiptare dhe të ekspertëve shqiptarë, për të krijuar Kodin Zgjedhor më të mirë të mundshëm. Po, konsensusi është gjithmonë i këshillueshëm, por jo gjithmonë i mundur. Kjo është jeta politike e Shqipërisë. Ne nuk jemi këtu për të gjykuar atë çfarë ndodh. Ne nuk jemi këtu për të gjykuar, në thelb, vendimet që merren në Shqipëri. Ne jemi këtu për të ndihmuar procesin.

**Por, problemi qëndron se, në mënyrë që rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të zbatohen, duhet që të dyja palët të bashkëpunojnë, pasi mazhoranca këtë herë nuk ka shumicën e duhur në Parlament, s'ka 84 vota, shumicën e cilësuar, për të miratuar Kodin Zgjedhor. Prandaj unë po këmbëngul te kjo pyetje.**

Ka raste kur konsensusi është i nevojshëm, ka raste kur mazhoranca vetë nuk mund të arrijë të vendimi. Siç e thashë edhe më parë, keni edhe pjesën tjetër të demokracisë, që është dialogu, pra dialogu midis mazhorancës dhe opozitës. Kjo është pjesa e jetës politike në Shqipëri, në të cilën palët e interesit duhet të punojnë me më shumë vizion, do të thosha, me më shumë mirëbesim të ndërsjellë dhe me vizion. Ky ndoshta është, siç po thosha që në fillim të intervistës, problemi i sotëm, pra që duhet të punohet për besimin e ndërsjellë, edhe përbrenda opozitës.

**Çfarë do të thotë kjo e fundit?**

Mendoj se të gjithë pajtohemi që një opozitë e fortë është e nevojshme për funksionimin e demokracisë, për të miratuar ligjet, për të marrë vendimet e rëndësishme, siç e thatë edhe ju. Opozita, për mendimin tonë, duhet të gjejë një mënyrë për të shkuar përtej ndarjes aktuale. Nuk e themi se si duhet të bëhet kjo, nuk po themi që zgjidhja gjyqësore parapëlqehet ndaj një marrëveshjeje. Në vizionin tonë të një bote ideale, një marrëveshje është gjithnjë më e mirë sesa një vendim gjykate. Gjithsesi, jam i bindur që ndarja e brendshme e opozitës sot duhet tejkaluar shpejt dhe me mençuri, në mënyrë që të ketë funksionim më të mirë të demokracisë shqiptare.

**Meqenëse jemi tek opozita, më lejoni t'ju pyes, cila është marrëdhënia që ju keni ndërtuar, ju personalisht, me opozitën? Komunikoni me të dyja pjesët e opozitës?**

Unë kam komunikim me të gjithë përfaqësuesit e opozitës dhe, meqë ra fjala, më lejoni të them që kam komunikim me të gjithë përfaqësuesit, në përgjithësi, të të gjithë spektrit politik në Shqipëri. Për t'iu kthyer pyetjes suaj, po, jam takuar me përfaqësuesit e të gjitha këtyre, t'i quajmë kështu, të të gjitha fraksioneve të palës opozitare. Kam marrë informacione tejet interesante, po ashtu kam përçuar edhe mesazhin që sapo jua thashë, që një marrëveshje do të ishte zgjidhja më e mirë. Por e kuptoj që ka një procedurë gjyqësore, prandaj askush, as qeveria, as Prezenca e OSBE-së, nuk mund të ndërhyjë në procedurat gjyqësore. Është ajo që kemi mësuar në shkollë, që pushteti gjyqësor është i pavarur dhe është elementi më i rëndësishëm i zbatimit të ligjit, në cilindo vend demokratik. Pra, gjyqi do të vazhdojë dhe unë nuk komentoj mbi atë që mund të ndodhë, por ndihem i detyruar të dërgoj mesazhin e gjetjes së marrëveshjes, veçanërisht kur takoj njerëz të të gjithë fraksioneve të opozitës.

**Kur ju u kërkoni që opozita të bashkëpunojë, të gjejë një marrëveshje, si ju përgjigjen ata, nëse mund të na e thoni?**

Tani po gërmoni në biseda private, por mund t'ju them që askush nuk përgjigjet, apo ta them kështu, të gjithë pajtohen që një marrëveshje është zgjidhje më e mirë sesa një vendim i imponuar nga gjykata apo nga lart. Në teori, të gjithë pajtohen me këtë, po.

**Por?**

Por, ju jeni gazetarja, ju duhet ta ndiqni çfarë ndodh. Unë e ndjek, u referohem edhe mediave për të kuptuar se çfarë ndodh, mediave dhe bisedave private. Pra, më tregoni ju se çfarë ndodh.

**OK. Ambasador, a përbën shqetësim për OSBE-në fakti që KQZ-ja ende nuk ka regjistruar komisionerët e Partisë Demokratike, meqenëse afati ka nisur, dhe nuk ka shpërndarë ende fondet, për Partinë Demokratike dhe për partitë tjera, për shkak të Partisë Demokratike?**

Siç jua thashë, një prej institucioneve me të cilat bashkëpunojmë shumë fort, dhe mund të them që ka vlerësim të ndërsjellë tejet të lartë midis nesh, pra Prezencës së OSBE-së dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Jam takuar me Komisionerin dhe përshtypja ime për Komisionerin dhe stafin e tij është që me siguri ata janë në gjendje të gjejnë një zgjidhje për cilindo problem. Ne kemi besim te puna e tyre.

**Më datën 3 mars, siç e përmendët pak më parë, do të merret një vendim nga gjykata për çështjen e ndasive, mosmarrëveshjeve në Partinë Demokratike. Por, nëse mungon ky vendim final, a do të ishte problem kjo për zgjedhjet në Shqipëri?**

Siç e thashë më parë, sistemi gjyqësor duhet të funksionojë pa ndërhyrje. Nga ana jonë, sigurisht që nuk ndërhyjmë, prandaj nuk spekulojmë për atë që mund të ndodhë, cili vendim mund të merret apo të mos merret. Siç jua thashë, institucionet që duhet të vendosin, cilido të jetë rezultati më 3 mars, kanë aftësinë, kanë kompetencën, kanë mençurinë, që të vendosin se cila do të jetë zgjidhja më e mirë për Shqipërinë.

**Ndërkohë, Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, z. Berisha dhe përfaqësues të tjerë të Partisë Demokratike kanë deklaruar, herë pas herë, se nëse zgjedhjet më 14 maj nuk do të jenë sipas standardeve më të larta demokratike, në Shqipëri do të ketë destabilizim. A jeni të përgatitur ju për këtë skenar?**

Personalisht, kam qenë dëshmitar i skenarëve tejet problematikë kur punoja në Libi, më 2011, dhe filloi revolucioni. U krijuan disa kushte dhe diçka ndodhi. Si sot një vit më parë, siç e dimë të gjithë, filloi lufta në Ukrainë. Unë isha në Moskë në atë kohë, saktësisht një vit më parë. Pra, kushtet e krizës janë të lexueshme, mund t'i vësh përreth teje. Unë jam prej tre muajsh në Shqipëri dhe nuk vërej kushtet për atë që ju e quani destabilizim, apo të themi, ndonjë krizë madhore. Personalisht, nuk i shoh. Siç e thashë më parë gjatë intervistës, është një gjë të jesh i qartë, i drejtpërdrejtë e i sinqertë kur je parti dhe flet për partinë tjetër, dhe është gjë tjetër, në demokraci, të shprehësh kërcënime. Është diçka që nuk është pjesë e rregullave demokratike. Askush, dhe nuk po i referohem dikujt posaçërisht, askush nuk duhet të përdorë kërcënime.

**Pra, ju mendoni që nuk ka vend për destabilizim dhe këto janë vetëm kërcënime, në një gjuhë tjetër që mund t'i quajmë, bluf, nga ana e z. Berisha?**

Nuk kam gjykim për këtë. Ju fola për përvojën time të kufizuar prej zyrtari ndërkombëtar të dërguar jashtë shtetit, kur e kam gjetur veten në situata krize. Mendoj se përgatitja e një krize është diçka që mund ta nuhasësh në ajër. Jam i sigurt që Shqipëria, dhe përgjithësisht kjo është përshtypja ime për Shqipërinë, që është vend i zgjuar, që ka arritur të dalë në mënyrë paqësore nga një periudhë e tmerrshme. Fundjavën e kaluar isha në Shkodër dhe vizitua vende ku ishin burgosur njerëzit më parë. Ishte një detaj, por me të vërtetë më bëri shumë përshtypje. Pra, njerëzit që janë kaq të zgjuar e të guximshëm nuk mund t'i lënë gjërat të shkojnë përtej pikës ku nuk kontrollohen më. Jam i sigurt që pjekuria do të triumfojë.

**Le të jetë kështu, z. Ambasador, sepse kjo çështja e nuhatjes është pak problematike, sepse shumë pak njerëz nuhatën që do niste Rusia një luftë në Ukrainë, meqenëse se ju ishit atëherë në vendngjarje. Por, ju lutem t'ju pyes për ngjarjet që ndodhin në parlamentin shqiptar, besoj që i keni ndjekur, atje është përkeqësuar situata politike. Mendoni që mazhoranca po e lejon opozitën të ketë të gjitha të drejtat e saj, të ushtrojë kontrollin parlamentar brenda parlamentit?**

Ju përmendët kontrollin parlamentar. Kontrolli është një prej detyrave më kryesore të cilitdo parlament, jo vetëm në Shqipëri. Kontrolli parlamentar ka një sërë rregullash, ka rregulla të shkruara e të pashkruara. Nëse mund ta them kështu, apeli ynë është që secila palë t'u përmbahet rregullave, të shkruara e të pashkruara, me dinjitet e pjekuri. Unë nuk gjykoj, por ne bëjmë thirrje që ky funksion të përdoret me dinjitet e pjekuri.

**Në fakt, i janë mohuar disa të drejta opozitës. Për shembull, nuk ngrihen komisione hetimore parlamentare, kryeministri s'pranon interpelanca. Përbën një problem kjo për ju, sepse nuk shohim reagim nga OSBE-ja? Ndërkohë, dikur ka pasur të tilla reagime.**

Sikurse ju thashë, fakti që reagimet tona nuk bëhen publike është ngaqë mendojmë se, në këtë situatë, gjëja më e mirë që mund të bëjmë është t'ua japim mesazhet bashkëbiseduesve tanë. Ne flasim me të gjithë, sikurse ju thashë, me çdo palë politike, dhe i përcjellim këto mesazhe. Mesazhi për procedurat parlamentare u është përcjellë qartë këtyre bashkëbiseduesve.

### **Dhe cili ishte mesazhi?**

Përderisa po ju them që veprojmë në mënyrë të heshtur, nuk jam në gjendje t'u tregoj tërë mesazhin, por mesazhi është: keni rregulla, të shkruara e të pashkruara, përdorini me pjekuri.

**Z. Ambasador, edhe një pyetje të fundit për një çështje që ju e prekët në fillim të intervistës dhe është një nga fushat që mbulon mandati i OSBE-së dhe ka lidhje me korrupsionin. A është e kënaqur OSBE-ja me nivelin e luftës kundër korrupsionit në Shqipëri, pasi institucione të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare flasin për një korrupsion endemik në Shqipëri? Shpresoj për një përgjigje sa më të drejtpërdrejtë meqenëse kjo është edhe pyetja e fundit.**

Jam takuar me strukturat kundër korrupsionit, e kam fjalën veçanërisht për SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimeve. Jo vetëm i kam takuar, por stafi im është në marrëdhënie pune të përditshme me këto institucione. Kam parë atmosferën që ekziston mes këtyre institucioneve dhe stafit tonë dhe është një gjë e mirë, pasi institucionet janë të gjendje të na kërkojnë asistencë dhe ne jemi në gjendje t'ua japim. Kjo është nga pikëpamja jonë. Nga puna e përditshme e tyre shihet se këto mekanizma po fillojnë të funksionojnë. Mendoj se janë në drejtimin e duhur dhe se lufta kundër korrupsionit, në fund, do të triumfojë në Shqipëri. Ana tjetër që punojmë lidhet me parandalimin. Jo vetëm në Shqipëri, në mbarë botën ka forma korrupsioni të cilat janë, ju i quajtët endemike, por le të themi që janë pjesë e traditës së mbarë botës. Detyra e një qeverie është t'i luftojë këto sjellje. Sot ka shumë mjete që nuk kanë ekzistuar në të kaluarën e që mund të na ndihmojnë. Një është si të bëhet transparente puna e administratës publike. Mund të bëhet në shumë mënyra. Një nga këto mënyra është përmes dixhitalizimit, shërbimeve elektronike. Menuja është shumë e pasur. Mjafton të zgjedhësh gjënë e duhur. Detyra jonë, në punën tonë të përditshme me institucionet e reja që luftojnë korrupsionin, është të përpiqemi t'i ndihmojmë të zgjedhin zgjidhjen e duhur. Kjo punë është shumë e rëndësishme dhe entuziazmuese për ne, pasi jemi të ndërgjegjshëm që po mundohemi t'i japim zgjidhje së bashku njërit prej problemeve që në Shqipëri perceptohet si në themel të procesit të përmirësimit.

**Z. Ambasador, nëse ju keni një mesazh të fundit për të dhënë, unë ju falënderoj shumë që ishit në emisionin “Pa censurë”.**

Folëm për institucionet, folëm për partitë politike, por në çdo vend ekziston edhe një shtyllë e tretë që është shoqëria civile. Ne punojmë me tërë shoqërinë civile. Mesazhi im për shikuesit është se dyert e Prezencës sonë janë të hapura. Ne mund të bëjmë shumë gjëra brenda mandatit tonë dhe e ftojmë shoqërinë civile, në veçanti gratë dhe të rinjtë, të vijnë me ide, pasi na pëlqejnë idetë e reja dhe do të donim të punonim për realizimin e tyre.

**Faleminderit, Ambasador!**

Faleminderit!

**Fund**